



UNIVERSITETI I GJAKOVËS “ FEHMI AGANI”

FAKULTETI I MJEKËSISË

DREJTIMI: INFERMIERI

PUNIM DIPLOME

**TEMA: PROMOVIMI I SHËNDETIT NË
INSTITUCIONE SHKOLLORE**

Mentori:

Prof.Ass. Dr. Naim Jerliu

Kandidati:

Ilir Kqira

Gjakovë, 2017



UNIVERSITETI I GJAKOVËS “ FEHMI AGANI”

FAKULTETI I MJEKËSISË

DREJTIMI: INFERMIERI

PUNIM DIPLOME

**TEMA: PROMOVIMI I SHËNDETIT NË
INSTITUCIONE SHKOLLORE**

Mentori:

Prof.Ass. Dr. Naim Jerliu

Kandidati:

Ilir Kqira

Gjakovë, 2017

FALËNDERIM

I falënderoj gjithë profesorët e mi në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Gjakovës.

Një falënderim i veçantë për mentorin tim, Prof.Ass.Dr. Naim Jerliu për ndihmën dhe mbështetjen që më ofroi gjatë gjithë punës sime, deri në finalizimin e punimit të temës së diplomës.

Falënderoj familjarët dhe miqtë që më ofruan përkrahje morale dhe financiare.

Faleminderit, gjithashtu, edhe për anëtarët e Komisionit Vlerësues.

JU FALEMINDERIT!

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	8
1.1. Përkufizimi i promovimit shëndetësor.....	9
1.2. Historiku i promovimit shëndetësor.....	10
1.3. Parimet e promovimit shëndetësor.....	11
1.4. Promovimi i shëndetit në shkolla.....	12
1.5. Shkollat promovuese të shëndetit.....	13
1.6. Strategjia e promovimit të shëndetit në shkolla.....	15
2. Qëllimi i punimit.....	18
3. Metodologjia (Materiali dhe metodat).....	19
4. Rezultatet.....	20
5. Diskutimi.....	27
6. Përfundimi.....	29
7. Rekomandimet.....	30
8. Referencat.....	31
9. CV e shkurtër e kandidatit.....	36

ABSTRAKTI

Qëllimi i studimit:

Qëllimi i këtij punimi është që të shpjegojë rëndësinë e promovimit të shëndetit në shkolla me qëllim të edukimit, informimit, dhe sigurimit të mundësive për të krijuar qëndrime të drejta për shëndetin, dhe për të mësuar e zbatuar sjellje të shëndosha, si dhe të vlerësohet aktiviteti promovues shëndetësor në shkollat e komunës së Gjakovës nëpërmjet studimit të rastit në shkollën fillore “Zef Lush Marku” në Brekoc të Gjakovës.

Materiali dhe metodat:

Hulumtimi përbëhet prej dy komponentave:

1. Shqyrtimit të literaturës në lidhje me promovimin e shëndetit në shkolla, dhe
2. Vlerësimi i aktiviteteve promovuese në shkollat e Gjakovës, nëpërmjet studimit të rastit - anketimit në shkollën fillore “Zef Lush Marku” në Brekoc të Gjakovës.

Në anketimin në lidhje me komponentin e dytë janë përfshirë gjithsej 10 mësimdhënës dhe poashtu edhe 20 nxënës të shkollës fillore “Zef Lush Marku” në Brekoc të Gjakovës. Për këtë qëllim është përgatitur pyetësor për mësimdhënësit dhe pyetësor për nxënësit. Përzgjedhja e mostrës ka qenë rastësore.

Rezultatet: Rezultatet e anketimit tregojnë nivel mjaft të ultë të aktiviteteve promovuese në shkollë. Vetëm rreth 30% e mësimdhënësve respondentë kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit, kanë punuar ata ose të tjerët në mbikëqyrjen ose koordinimin e promovimit shëndetësor në këtë shkollë në aktivitete me stafin arsimor shëndetësor. Ndërsa sa i përket mbështetjes për aktivitetet promovuese, rreth 40% e mësimdhënësve kanë deklaruar se nuk janë ofruar aktivitete ose shërbime për shkollën nga organizatat joqeveritare (OJQ), apo institucione shëndetësore lokale, ndërsa në mesin e nxënësve rreth 45% të respondentëve kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit nuk është ofruar ndonjë aktivitet ose shërbime për shkollën nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal. Rreth 75% e nxënësve kanë deklaruar se nuk kanë pasur mbështetje për aktivitete promovuese. Rreth 50% e mësimdhënësve kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit nuk janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet në mediat elektronike të shkollës.

Përfundime dhe rekomandime: Nga të dhënat e hulumtimit mund të thuhet se në shkollën fillore “Zef Lush Marku” në Brekoc, Gjakovë, ka mungesë të aktiviteteve promovuese, dhe të mbështetjes së nevojshme për aktivitete të këtij lloji. Prandaj, në të ardhmen duhet të ketë rritje të aktiviteteve dhe të mbështetjes në këtë drejtim. Aktivitetet promovuese në shkolla janë të domosdoshme për nxënësit në rritjen e vetëdijes dhe kujdesit për jetë më të shëndetshme. Prandaj shkolla duhet të hartojë një Program të aktiviteteve promovuese shëndetësore mbështetur në Strategjinë e shkollave promovuese të shëndetit.

Fjalët kyçe: Promovimi i shëndetit, shëndeti në shkolla, nxënësit-komuniteti.

ABSTRACT

The purpose of the study:

The purpose of this study is to explain the importance of health promotion in schools with education purpose, to inform and secure possibilities of creating straight attitudes for health, and to learn and implement healthy behaviours. Furthermore, this study extends also to assessing health promotion activities in schools of Gjakova Municipality through a case study at “Zef Lush Marku” elementary school in Brekoc, Gjakova.

Material and Methods: This research consists of dy components:

1. Literature review in regards to health promotion in schools, and
2. Assessment of promotional activities in schools of Gjakova through a case study - questionnaires conducted at elementary school “Zef Lush Marku” in Brekoc, Gjakova.

In the questionnaires, there were involved 10 teachers and 20 students from “Zef Lush Marku” elementary school in Brekoc, Gjakova. For this reason, there were two questionnaires prepared, one for teachers and one for the students. Samples were selected randomly.

Results: The results conducted from questionnaires show a low level of promotional activities at this school. Only 30% of teacher respondents have declared that during the last 12 months, they or others have worked on supervising or coordinating health promotion in this school with health educational staff. While, regarding the support of promotional activities, around 40% of teachers have declared that there were no activities or services for this school offered by non-governmental organisations, or local health institutions. In the other hand, among students, around 45% of respondents have declared that in the last 12 months there were no activities or services for the school offered by non-governmental organisations, or local health institutions. Around 75% of students declared that they did not have any support for promotional activities. Almost 50% of teachers have declared that in the last 12 months they have not taken any activities or services to publish health promotion such as posters in schools or ifnormation posts on electronic media of the school.

Conclusions and recommendations: From the data of the research, we can say that in “Zef Lush Marku” elementary school in Brekoc, Gjakova, there is a lack of promotional activities, and there is a lack of necessary support for activities of this kind. Therefore, in the future, there shall be an increase regarding activities and support in this direction. Promotional activities in schools are necessary for students in increasing awareness and caring for a healthier life. Therefore the school shall compose a health promotional activities program to support the strategy health promotion schools.

Keywords : Health promotion, health in schools, students - community .

1.HYRJJE

Promovimi i shëndetit është aktivitet për të rritur kontrollin mbi shëndetin, për të krijuar mjedis të shëndoshë dhe për parandalimin e sëmundjeve në vend, duke u fokusuar në njerëz në rrezik për sëmundje të caktuara.¹

Promovimi i shëndetit mbështet të gjitha shërbimet shëndetësore që mbulon dy fusha specifike:

- ✓ *Promovimi i shëndetit (parandalimi i sëmundjes)*
- ✓ *Ngritja e kapaciteteve në komunitet*

Një nismë tjetër kohëve të fundit ka qenë për zbatimin e projekteve që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve të komunitetit rreth menaxhimit të çështjeve shëndetësore nga: rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit nga faktorët që krijojnë jetë të shëndetshme, forcimi i kapaciteteve të secilit komunitet për të identifikuar çështjet me interes për ta, rritja e nivelit të pjesëmarrjes në aktivitetet e shëndetshme. Këto iniciativa janë mbështetur nga zhvillimi profesional i punonjësve, së bashku me trajnimin dhe mbështetjen e profesionistëve të tjerë të shëndetësisë për të siguruar bazat e ofrimit të shërbimit shëndetësor të standardeve më të larta.²

2.1. PËRKUFIZIMI I PROMOVIMIT SHËNDETËSOR

Promovimi i shëndetit është procesi që ju mundëson njerëzve për të rritur kontrollin mbi shëndetin dhe në këtë mënyrë për të përmirësuar shëndetin e tyre. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, Karta e Otavës 1986).³ Ky proces përfshin popullsinë në tërësi në kontekstin e jetës së tyre të përditshme. Aktivitetet janë përshtatur drejt promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve në vend, duke u fokusuar në njerëz në rrezik për sëmundje të caktuara. Ky proces nënkupton zhvillimin e individit, grupit, komunitetit dhe paraqet strategji sistematike për të përmirësuar njohuritë e shëndetit, qëndrimet, aftësitë dhe sjelljet. Promovimi i shëndetit është tërësia e masave dhe veprimtarive të ndërmarra nga institucionet e kujdesit shëndetësor, punonjësit shëndetësor dhe komunitetit me qëllim përmirësimin e mirëqenies fizike,

¹ Health Promotion. “Health promotion” Vic Health. <https://www.vichealth.vic.gov.au/about/health-promotion>

² Health promotion. <https://www.flyingdoctor.org.au/qld/our-services/primary-health-care-services/health-promotion-qld/>

³ “Health Promotion” Australian health promotion association ,Australia, 2014

mendore e sociale. Promovimi i shëndetit përfshinë veprime si: informimin e njerëzve rreth sjelljeve që ata duhet pasur për të qëndruar të shëndetshëm, trajtimin e gjërave në komunitet që ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien e tyre, aktivitetet promovuese shëndetësore që fokusohen drejt promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve.⁴




Foto.1. Llogo e Promovimit Shëndetësor e përdorur nga OBSH

Konferenca e parë ndërkombëtare për promovimin e shëndetit është mbajtur në Otava, Kanada, më 21 nëntor të vitit 1986. Në këtë konferencë ishte aprovuar Karta e Otavas, që definojnë promovimin shëndetësor dhe pesë fushat kryesore të veprimit në promovimin e shëndetit (hartimi i politikave të shëndetshme publike, krijimi i mjediseve mbështetëse për shëndetin, forcimi i veprimit të komunitetit për shëndetin, zhvillimi i aftësive personale, dhe ri-orientimi i shërbimeve shëndetësore).⁵

⁴ Vic health ‘Health Promotion’, Australia , 2009

: <https://www.vichealth.vic.gov.au/about/health-promotion>

⁵ The Ottawa Charter for Health Promotion

2.2. HISTORIKU I PROMOVIMIT SHËNDETËSOR

Termi “ Promovim i Shëndetit “ është shfaqur në vitin 1945 nga Henry E. SINGERIST, historiani i madh mjekësor, i cili ka përcaktuar katër detyrat kryesore të mjekësisë:

- **Promovimin e shëndetit;**
- **Parandalimin e sëmundjes;**
- **Trajtimin e të sëmurëve;**
- **Rehabilitimin.**

Deklarata e tij thoshte se shëndeti është promovuar duke siguruar një standard të denjë jetese, kushte të mira të punës, arsimim, kulturë, pushim dhe rekreacion, po ashtu nga ndikimi i edukatorëve dhe mjekëve. Ai gjeti reflektime 40 vjet më vonë në Kartën e Otavës për promovimin e shëndetit. Që në fillim duhet përmendur se literatura lidhur me konceptet dhe praktikatat e promovimit shëndetësor në këto njëzet vitet e fundit është shumë-kuptimëshe dhe nganjëherë e pa qartë lidhur me përkufizimin, parimet dhe praktikatat në këtë fushë.

Në vitin 1985, Tones e përkufizoi promovimin shëndetësor si: “ Çfarëdo aktiviteti apo veprimtarie që synon garantimin e shëndetit “. Tre vjet më parë (1982), në fakt, Dennis e kishte përkufizuar promovimin shëndetësor në mënyrë pak a shumë të ngjajshme, duke nënvizuar se: “Promovimi shëndetësor mbulon të gjitha aspektet e aktiviteteve dhe programeve që synojnë përmirësimin e gjendjes shëndetësore të individëve dhe komunitetit në tërësi“. Promovimi i shëndetit është proces i fuqizimit të njerëzve për të rritur kontrollin mbi shëndetin e tyre dhe të përcaktuesve të shëndetit përmes përpjekjes për edukim.

Promovimi i shëndetit fokusohet në nevojën e gjithë popullsisë, e cila mund të ndahet në katër grupe:

- **Popullsia e shëndetshme ;**
- **Popullsia me faktorët e rrezikut ;**
- **Popullsia me simptoma ;**
- **Popullsia me sëmundje apo çrregullime.⁶**

⁶ Terris M. Concepts of health promotion: dualities in public health theory. J Public Health Policy. 1992;13:267–76. [PubMed] : <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3326808/>

2.3. PARIMET E PROMOVIMIT SHËNDETËSOR

Organizata Botërore e Shëndetësisë në vitin 1986 i ka formuluar parimet bazë të promovimit shëndetësor si vijojnë më poshtë:

- ✓ **Promovimi shëndetësor përfshin popullatën në tërësi;**
- ✓ **Promovimi shëndetësor fokusohet në faktorët përcaktues ose shkaktarët e sëmundjeve;**
- ✓ **Promovimi shëndetësor kombinon metoda dhe përjasje të ndryshme, por që gjithësesi plotësojnë njëra-tjetrën;**
- ✓ **Promovimi shëndetësor ka synim kryesor përfshirjen dhe bashkëpunimin konkret dhe të drejtpërdrejtë të popullatës;**

Këto parime në fakt, ishin një thirrje për ndryshime në perspektivën dhe në pikëpamjet e përmirësimit të shëndetit të popullatës. Dy parimet e para i kushtohen një perspektive “holistike” mbi shëndetin, në vend që të fokusohen në individët e sëmurë apo në subjektet me rrezik të lartë për zhvillimin e sëmundjeve të caktuara, punonjësit e shëndetësisë duhet të drejtojnë vëmendjen e tyre nga popullata në tërësi, me synimin kryesor parandalimin e sëmundjeve dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në nivel komunitar. Dy parimet e fundit, nga ana tjetër, theksojnë faktin se garantimi i shëndetit të popullatës nuk është as “privilegj” dhe as detyrim vetëm i punonjësve të shëndetësisë, por është “privilegj” dhe përgjegjësi e të gjithë individëve të komunitetit. Ky parim, i pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit aktiv të të gjithë komunitetit, përbën edhe ndryshimin rrënjësor të perspektivës dhe strategjisë për përmirësimin e qëndrueshëm të shëndetit dhe mirëqenies së popullatës në tërësi. Promovimi shëndetësor synon arritjen e barazisë në shëndet për të gjithë individët e komunitetit. Aktivitetet dhe programet në fushën e promovimit shëndetësor synojnë reduktimin dhe zbutjen e pabarazive si dhe në krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë individët në mënyrë që ata të gëzojnë shëndet të plotë.⁷

⁷ Gentiana Qirijako, Genc Burazeri, Enver Roshi, Drita Gera: Shëndeti publik.Tiranë

2.4. PROMOVIMI I SHËNDETIT NË SHKOLLA

Shkollat janë përcaktuar si institucione në shërbim të të rinjve të moshës 4-19 vjet, duke ofruar arsimin fillor ose të mesëm. Në të janë përfshirë të gjitha programet me një bazë shkollore. Në programet e tilla mund të përfshihet dikush i lidhur me shkollën, duke përfshirë stafin dhe prindërit, si dhe të rinjtë.⁸

Rëndësia e promovimit të shëndetit në shkolla: Promovimi i shëndetit në shkolla, është një nga elementet bazë të edukimit të nxënësve për të cilin shkollat duhet të investojnë sot dhe në të ardhmen. Promovimi i shëndetit në ambientet shkollore është i rëndësishëm, sepse shëndeti dhe arsimi janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën si:

- Fëmijët e shëndetshëm kanë më shumë gjasa të jenë me efektiv;
- Arsimimi luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe rezultatet e shëndetit gjatë jetës,
- Promovimi i shëndetit të stafit shkollor mund të shpie drejt kënaqshmërisë dhe rritë vijueshmërinë.

Rëndësia e promovimit të shëndetit në shkolla është e madhe, pasi që shkolla mbulon një pjesë të madhe të popullatës duke e përfshirë këtu rininë. Afërsisht 1/5 e gjithë popullatës është në shkolla dhe fillet apo bazat mbi shëndetin vihen në këtë fazë të jetës. Vlerat themelore të një iniciative të shkollave promovuese të shëndetit e cila bëhet edhe përmes partneritetit mund të jenë: respektimi i vetes, respektimi i ndryshimeve tek të tjerët, respekti për mjedisin, shfrytëzimi i tërësisë së ofertës që e bën shkolla si kurrikulave, familjes dhe bashkësisë me tërë spektrin e mundshëm të individëve, grupeve të interesit dhe institucioneve qeveritare dhe joqeveritare të ndërlidhura me konceptin e shkollave promovuese të shëndetit. Prandaj mbrojtja dhe përparimi i shëndetit të fëmijës duhet të jetë synim parësor i shkollave dhe qeverisë së Kosovës. Shëndeti është pasuria më e madhe, të gjithë së bashku duhet të kujdesemi dhe ta ruajmë atë.

⁸ "Sarah Stewart-Brown Professor of Public Health Division of Health in the University of Warwick Coventry United Kingdom"

2.5 SHKOLLAT PROMOVUESE TË SHËNDETIT

Shkolla Promovuese e Shëndetit mund të përkufizohet si çdo aktivitet i ndërmarrë për të përmirësuar dhe mbrojtur shëndetin e gjithë komunitetit në shkollë. Arsimimi shëndetësor në shkollë është një aktivitet komunikimi dhe përfshinë mësimnxënien dhe mësimdhënien që kanë të bëjnë me njohuritë, besimet, sjelljet, vlerat, aftësitë dhe shkathtësitë. Shkollat promovuese të shëndetit ngrisin kapacitetet e të rinjve për të vepruar, dhe sjellë ndryshime. Shkollat promovuese të shëndetit ofrojnë një mjedis, në të cilin të rinjtë fitojnë ndjenjën për arritjen e rezultateve, duke punuar me arsimtarët dhe të tjerët. Fuqizimi i të rinjve me vizionet dhe idetë e tyre, mundëson që ata të kenë ndikim në jetën e tyre, dhe kushtet e jetesës. Ky është definicioni i Organizatës Botërore të Shëndetësisë.” (OBSh,1997). Në kontekstin tonë promovimi shëndetësor mund të prezantohet si kombinim i edukimit shëndetësor, dhe aktiviteteve tjera që mund t’i ndërmarrë shkolla për të ruajtur dhe përmirësuar shëndetin e të gjithë atyre që gjinden në të. Te gjithë kujdesemi për fëmijët, ata janë e ardhmja e Kosovës. “Çdo fëmijë dhe person i ri, ka të drejtë, dhe duhet të ketë mundësi, që të edukohet në shkollë për promovimin e shëndetit.” (Rezoluta e Konferencës Ndërkombëtare të Promovimit të Shëndetit në Selanik, 1997).

Historiku në Europë: Shkolla promovuese e shëndetit e ka origjinën nga simpoziumi i përbashkët i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) në vitin 1996 dhe grupi skocez për edukim shëndetësor i mbajtur në Skotlandë. Nga viti 1993, 43 vende evropiane janë anëtarësuar në rrjetin evropian të shkollave promovuese të shëndetit. Përmes zbatimit të këtij programi edhe Kosova synon të jetë pjesë e këtij rrjeti dhe të përfitojë nga shkëmbimi i përvojave të vendeve të tjera anëtare të rrjetit.

Historiku në Kosovë: Ky program në Kosovë ka filluar me nismë të OBSh-së, UNICEF-it, IOM-it, ku më vonë në vitin 2004 me qëllim të jetësimit të këtij programi u lidh një marrëveshje mirëkuptimi në mes të tri ministrive, ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë, ministrisë së shëndetësisë dhe ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor.⁹

⁹ Raport shkollat promovuese të shëndetit nëper vite” Prishtinë 2013



Foto.2. Java e promovimit të shëndetit në shkollën "Yll Morina" Gjakovë 30 prill 2013

Projekti i javës së promovimit të shëndetit, është projekt i cili realizohet çdo vit nga ana e komitetit ndërministror të programit "Shkollat Promovuese të Shëndetit". Ky projekt realizohet në institucione të arsimit fillor, në qendrat kryesore të Kosovës.

Në vitin 2013 edhe në Gjakovë, në shkollën fillore "Ylli Morina", u mbajt "Java e promovimit të shëndetit" me moton "Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur".

Gjatë kësaj jave, janë realizuar aktivitete edhe në komunat: Prishtinë- Shkolla Fillore "Hasan Prishtina", Pejë- Shkolla Fillore "Tetë Marsi", Prizren- Shkolla Fillore "Lidhja e Prizrenit", Gjilan- Shkolla Fillore "Thimi Mitko", Ferizaj- Shkolla Fillore "Jeronim De Rada" dhe Mitrovicë- Shkolla Fillore "Migjeni".¹⁰

¹⁰ Xheladin Sh. Ujkani : Raporti përfundimtar i javës së promovimit të shëndetit, "Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur" (23-30 Prill, 2013) ”

2.6. STRATEGJIA E PROMOVIMIT TË SHËNDETIT NË SHKOLLA

Kosova e ka “Strategjinë e promovimit të shëndetit në shkolla”, e cila është aprovuar në vitin 2006, me qëllim të zbatimit të parimeve themelore të shkollave promovuese të shëndetit të Kosovës, bazuar edhe në mundësitë lokale si dhe respektimin e burimeve njerëzore e financiare, dhe infrastrukturën shoqëruese.

Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit paraqet kornizën themelore përmes së cilës, sektorët e arsimit, shëndetësisë, mjedisit, rinisë, individët, organizatat qeveritare e joqeveritare (OJQ), sektori i biznesit dhe të gjithë të interesuarit, do të zbatojnë programe të veqanta, me qëllim të ngritjes së cilësisë së punës, si të mësimdhënjes ashtu edhe të mësimnxënjes, në një mjedis shkollor të shëndetshëm e të përshtatshëm, pa dhunë, diskriminim, dhe të hapur për ide të reja. Kjo do të mundësojë që bashkësia të realizojë synimet në ngritjen e cilësisë së jetës, me një bashkëpjesëmarrje aktive në këtë proces.

Misioni i Strategjisë është sigurimi i mjedisit shkollor të shëndetshëm dhe miqësorë, të sigurt përmes edukimit shëndetësorë, promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe forcimit të partneritetit ndërmjet shkollës, prindërve dhe komunitetit. Për të realizuar misionin tonë, duhet të jetësohen edhe mekanizmat përkatës të parashikuar brenda fushave, si ajo e arsimit, mjedisit, shëndetësisë, ekonomisë dhe të një mjedisi të përshtatshëm përkrahës politiko-administrativ, po ashtu edhe zvogëlimi i rasteve të dhunës në shkolla do të jetë tregues i zbatimit të suksesshëm të strategjisë dhe misionit të saj.

Objektivat strategjikë:

Strategjia e shkollave promovuese të shëndetit, identifikon 6 objektiva strategjikë. Këto objektiva janë :

1. Mjedis i shëndetshëm dhe përkrahës nga ana e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve,
2. Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie e mësimnxënie,

3. Kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe materiale,
4. Përkujdesje cilësore dhe e vazhdueshme për shëndetin e nxënësve,
5. Shkallë e ulët e dhunës në shkollë,
6. Nivel i kënaqshëm i kulturës shëndetësore dhe mjedisore tek nxënësit.

Në Kosovë sipas statistikave, në bankat shkollore sot gjenden afro $\frac{1}{4}$ ose $\frac{1}{5}$ e numrit të përgjithshëm të banorëve. Prej rreth 2 milionë banorësh, sa ka Kosova, në sistemin arsimor llogaritet se ka mbi 450.000 nxënës. Masa e vetëdijesimit për mjedisin dhe shëndetin mund të jetë, informimi i prindërve për ndikimin e mjedisit në gjendjen shëndetësore të pjesëmarrësve në procesin e arsimit në takimet e prindërve, dhe inkurajimi i tyre për punë të përbashkët në çështje lidhur me shëndetin, bashkimi në aktivitete të përbashkëta në shkolla me pjesëmarrjen vetjake në aktivitete të mirëmbajtjes së rregullt të mjedisit dhe përparimit e ruajtjes së shëndetit, hartimi i materialeve të përshtatshme për nivele të ndryshme me pjesëmarrje të përfituesve dhe trajnimi i nxënësve, personelit në arsim, dhe prindërve me qëllim të ngritjes së njohurive lidhur me mjedisin dhe shëndetin, duke mundësuar dhe inkurajuar pjesëmarrje të ekspertëve për fushat e mjedisit të shëndetësisë, dhe ekspertë të tjerë në rolin e këshilltarëve gjatë përpilimit dhe realizimit të këtyre materialeve.¹¹

Prindërit kanë një rol të fuqishëm të mbështesin, të ndihmojnë, udhëzojnë, fëmijët e tyre rreth mësimave për shëndetin, që mund të ndihmojnë në formimin e një mjedisi të shëndetshëm shkollos. Prindërit për shkollat e shëndetit janë për të ndihmuar grupet shkollore, shoqatat mësues prind, organizatat mësues prind ku kemi disa lloje burimesh të edukimit të prindërve rreth:

- Edukimi fizik në bazë të shkollës dhe aktiviteti fizik,
- Menaxhimi i sëmundjeve kronike shëndetësore në mjediset shkollore,
- Të sigurojë prindërit për strategjitë dhe veprimet për të përmirësuar mjedis të shëndetit në shkollë praktike,

¹¹ "Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë" Prishtinë 2009

- Të japin sugjerime në mënyrat për të ndjekur përparimin dhe të angazhohen prindërit në ndryshimin e mjedisit shëndetësor shkollor.



Foto.3. "Prindërit për shkollë të shëndetshme" Programi i aktivitetit fizik në shkollat gjithëpërfshirëse¹²

¹² "Health promotion strategy"

3. QËLLIMI

Qëllimi i këtij punimi është që të shpjegojë rëndësinë e promovimit të shëndetit në shkolla me qëllim të edukimit, informimit, dhe sigurimit të mundësive për të krijuar qëndrime të drejta për shëndetin, dhe për të mësuar e zbatuar sjellje të shëndosha, si dhe të vlerësohet aktiviteti promovues shëndetësor në shkollat e komunës së Gjakovës nëpërmjet studimit të rastit në shkollën fillore “Zef Lush Marku” në Brekoc të Gjakovës.

4. METODOLOGJIA

Hulumtimi përbëhet prej dy komponentave:

1. Shqyrtimit të literaturës në lidhje me promovimin e shëndetit në shkolla, dhe
2. Vlerësimi i aktiviteteve promovuese në shkollat e Gjakovës, nëpërmjet studimit të rastit - anketimit në shkollën fillore “Zef Lush Marku” në Brekoc të Gjakovës.

Në anketimin në lidhje me komponentin e dytë janë përfshirë gjithsej 10 mësimdhënës dhe poashtu edhe 20 nxënës të shkollës fillore “Zef Lush Marku” në Brekoc të Gjakovës. Për këtë qëllim është përgatitur pyetësor për mësimdhënësit dhe pyetësor për nxënësit. Përzgjedhja e mostrës ka qenë rastësore. Për anketimin është marrë leje nga drejtorja e shkollës.

Pyetësi për mësimdhënës ka përfshirë pyetje që kanë të bëjnë me :

- Vlerësimin e mësimdhënësve për aktivitete shëndeti ose shërbime të promovimit?
- A ka siguruar shkolla juaj dhurata, njohje publike, certifikata apo çmime për pjesëmarrje në programet e promovimit të shëndetit?
- A është ofruar ndonjë aktivitet ose shërbime për shkollën nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal ?

- A janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet shfaqën në mediat elektronike të shkollës?
- A ka ofruar shkolla juaj shqyrtimin oral shëndetsorë ose vaksinimin për nxënës?

Ndërsa në pyetësonin për nxënës janë shtruar pyetje në lidhje me:

- A ka ofruar shkolla juaj arsimim rreth menaxhimit të ushqimit, aktivitete fizike apo këshillim në palestër?
- A keni marrë ndonjë subvencion për aktivitete promovuese, të tilla si programet për humbje në peshë, ose programe për ndërprerjen e duhanit?
- A ka ndonjë aktivitet ose programe fizike të ndryshme midis grupeve të shkollës, p.sh. një garë në mes nxënësve nga klasat e ndryshme?
- A keni punuar ju ose të tjerët në mbikëqyrjen ose koordinimin e promovimit shëndetsor në këtë shkollë në ato aktivitete me stafin arsimor shëndetësor?

Analiza statistikore e të dhënave është bërë në programin Excel. Rezultatet janë prezantuar në formë tabelash dhe grafikonesh.

5. REZULTATET

Në hulumtimin tonë në lidhje me njohuritë, përkatësisht aktivitetet promovuese në shkolla janë përfshirë gjithsej 10 mësime dhe 20 nxënës të shkollës fillore “Zef Lush Marku” në Brekoc të Gjakovës. Në vijim janë paraqitur rezultatet e anketimit të mësimeve dhe nxënësve, të ilustruara nëpërmjet tabelave dhe grafikoneve.

5.1 Anketimi i mësimeve

Në anketim janë përfshirë gjithsej 10 mësime, prej tyre 5 femra dhe 5 meshkuj

Tabela.1. Mësimeve të anketuar sipas gjinisë


Numri i mësimeve të anketuar					
Gjinia				Gjithsej	
Meshkuj		Femra			
Nr	%	Nr	%	Nr	%
5	50 %	5	50%	10	100%

Sa i përket moshës, 50 % e mësimeve që kanë marrë pjesë në anketim ishin të moshës 36-49 vjeq, mbi 50 vjeq ishin 40 % dhe prej 25-35 vjeq ishin 10% e mësimeve të anketuar.

Tabela.1.2 Mësimeve të anketuar sipas moshës

Numri i mësimeve të anketuar							
Moshë						Gjithsej	
25-35 vjeq		36-49 vjeq		50+ vjeq			
Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
1	10%	5	50%	4	40%	10	100%

Grafikoni. 1.1 Mësimdhënësit e anketuar sipas moshës



5.1.1. Aktivitetet promovuese të shëndetit në shkolla- sipas anketimit të mësimdhënësve

Rezultatet e anketimit të mësimdhënësve e tregojnë nivel mjaft të ultë të aktiviteteve promovuese në shkollë. Më shumë përgjigje pozitive ka pasur vetëm për disa forma të aktiviteteve, ndërsa është raportuar nivel shumë i ultë i përkrahjes për organizim të aktiviteteve të ndryshme promovuese shëndetësore qoftë nga shkolla, nga organizata të tjera apo nga institucione lokale.


Vetëm rreth 30% e mësimdhënësve respondentë kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit, kanë punuar ata ose të tjerët në mbikëqyrjen ose koordinimin e promovimit shëndetësor në këtë shkollë në aktivitete me stafin arsimor shëndetësor. Rezultat më i mirë është deklaruar vetëm në lidhje me shqyrtimin e kujdesit oral dhe vaksinimit, me ç'rast rreth 90% e mësimdhënësve kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit shkolla ka organizuar aktivitete promovuese për shqyrtimin oral ose vaksinim për nxënës. Ndërsa sa i përket mbështetjes për aktivitetet promovuese, rreth 40% e mësimdhënësve kanë deklaruar se nuk janë ofruar aktivitete ose shërbime për shkollën nga organizatat joqeveritare (OJQ), apo institucione shëndetësore lokale.

Rreth 60% e mësimeve kanë deklaruar se janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet e shfaqura në mediat elektronike të shkollës.

Tabela. 1.3 Aktivitetet promovuese të shëndetit në shkolla sipas mësimeve

Pyetjet	Përgjigjet	
	Po	Jo
1.Gjatë 12 muajve të fundit, a ka ofruar shkolla juaj shqyrtimin oral shëndetësor ose vaksinimin për nxënës?	90%	10%
2.Gjatë 12 muajve të fundit, a ka ofruar shkolla juaj arsimim rreth menaxhimit të ushqimit, aktivitete fizike apo këshillim në palestër?	50%	50%
3.Gjatë 12 muajve të fundit, shkolla juaj a ka ofruar shërbimet e identifikimit për abuzim fizikë, seksual, ose emocional për nxënës?	80 %	20%
4.Gjatë 12 muajve të fundit a keni marrë ndonjë subvencion për aktivitete promovuese, të tilla si programet humbje në peshë, ose programe për ndërprerjen e duhanit ?	90%	10%
5. Gjatë 12 muajve të fundit, a ju ka vlerësuar shkolla për aktivitete shëndeti ose shërbime të promovimit?	80%	20%
6. Gjatë 12 muajve të fundit, a ka siguruar shkolla juaj dhurata, njohje publike, certifikata apo çmime për pjesëmarrje në programet e promovimit të shëndetit?	70%	30%
7. Gjatë 12 muajve të fundit, a është ofruar ndonjë aktivitet ose shërbime për shkollën nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal?	60%	40%
8. Gjatë 12 muajve të fundit a janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet shfaqën në mediat elektronike të shkollës?	60%	40%
9. Gjatë 12 muajve të fundit a ka ndonjë aktivitet ose programe fizike të ndryshme midis grupeve të shkollës, p.sh. një garë në mes nxënësve nga klasat e ndryshme?	80%	20%
10. Gjatë 12 muajve të fundit, a keni punuar ju ose të tjerët në mbikëqyrjen ose koordinimin e promovimit shëndetësor në këtë shkollë në ato aktivitete me stafin arsimor shëndetësor?	30%	70%

Grafikoni.1.3. Aktivitetet promovuese të shëndetit në shkolla sipas mësimdhënësve për aktivitetet 1 deri 10 sipas tabelës 1.3




5.2 Anketimi i nxënësve

Për qëllime të hulumtimit janë anketuar gjithsej 20 nxënës, prej tyre 13 meshkuj dhe 7 femra.

Tabela.2.1 Nxënësit e anketuar sipas gjinisë

Nxënësit e anketuar sipas gjinisë						
Gjinia					Gjithsej	
Meshkuj		Femra				
Nr	%	Nr	%	Nr	%	
13	65 %	7	35%	20	100%	

Grafikoni.2.1 Nxënësit e anketuar sipas gjinisë




5.2.1. Aktivitetet promovuese të shëndetit në shkolla sipas anketimit të nxënësve

Rezultatet e anketimit të nxënësve tregojnë nivel mjaft të ultë të aktiviteteve promovuese në shkollë. Më shumë përgjigje pozitive ka pasur vetëm për disa forma të aktiviteteve, ndërsa është raportuar nivel shumë i ultë i përkrahjes për organizim të aktiviteteve të ndryshme promovuese shëndetësore qoftë nga shkolla, nga organizata të tjera apo nga institucione lokale. Rreth 80% janë përgjigjur se në shkollë gjatë 12 muajve të fundit, është ofruar ndonjë formë e shqyrtimit oral shëndetësor ose vaksinimi për nxënës, ndërsa rreth 95% kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit ka pasur ndonjë aktivitet ose programe fizike të ndryshme midis grupeve të shkollës. Në pothuajse të gjitha pyetjet tjera në lidhje me aktivitete promovuese ka pasur përgjigje të cilat tregojnë përqindje të ultë të aktiviteteve. Kështu, p.sh, rreth 75% e nxënësve kanë deklaruar se nuk kanë pas mbështetje për aktivitete promovuese si programet për humbje në peshë apo programe për ndërprerjen e duhanit. Rreth 45% të respondentëve kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit nuk është ofruar ndonjë aktivitet ose shërbime për shkollën nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal, ndërsa 50% kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit nuk janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet në mediat elektronike të shkollës.

Tabela.2.2. Rezultatet e pyëtësorit të nxënësve në lidhje me aktivitetet promovuese të shëndetit në shkolla.

Pyetjet	Përgjigjet	
	Po	Jo
1.Gjatë 12 muajve të fundit, a ka ofruar shkolla juaj shqyrtimin oral shëndetësor ose vaksinimin për nxënës?	80%	20%
2.Gjatë 12 muajve të fundit, a ka ofruar shkolla juaj arsimim rreth menaxhimit të ushqimit, aktivitete fizike apo këshillim në palestër?	75%	25%
3.Gjatë 12 muajve të fundit, shkolla juaj a ka ofruar shërbimet e identifikimit për abuzim fizik, seksual, ose emocional për nxënës ?	20 %	80%
4.Gjatë 12 muajve të fundit a keni marrë ndonjë subvencion për aktivitete promovuese, të tilla si programet humbje në peshë, ose programe për ndërprerjen e duhanit?	25%	75%
5. Gjatë 12 muajve të fundit, a ju ka vlerësuar shkolla për aktivitete shëndeti ose shërbime të promovimit?	55%	45%
6. Gjatë 12 muajve të fundit, a ka siguruar shkolla juaj dhurata, njohje publike, certifikata apo çmime për pjesëmarrje në programet e promovimit të shëndetit?	50%	50%
7. Gjatë 12 muajve të fundit, a është ofruar ndonjë aktivitet ose shërbime për shkollën nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal?	55%	45%
8. Gjatë 12 muajve të fundit a janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet shfaqën në mediat elektronike të shkollës?	50%	50%
9. Gjatë 12 muajve të fundit a ka ndonjë aktivitet ose programe fizike të ndryshme midis grupeve të shkollës, p.sh. një garë në mes nxënësve nga klasat e ndryshme?	95%	5%
10. Gjatë 12 muajve të fundit, a keni punuar ju ose të tjerët në mbikëqyrjen ose koordinimin e promovimit shëndetësor në këtë shkollë në ato aktivitete me stafin arsimor shëndetësor?	25%	75%

Grafikoni.2.2 Rezultatet e pyëtësorit të nxënësve në lidhje me aktivitetet promovuese të shëndetit në shkollë.



6. DISKUTIM

Rezultatet e anketimit të mësimeve të mesme e tregojnë nivel mjaft të ultë të aktiviteteve promovuese në shkollë. Më shumë përgjigje pozitive ka pasur vetëm për disa forma të aktiviteteve, ndërsa është raportuar nivel shumë i ultë i përkrahjes për organizim të aktiviteteve të ndryshme promovuese shëndetësore qoftë nga shkolla, nga organizata të tjera apo nga institucionet lokale. Edhe rezultatet e anketimit të nxënësve tregojnë nivel mjaft të ultë të aktiviteteve promovuese në shkollë, ndërsa ka pasur raportim vetëm për disa forma të aktiviteteve, është raportuar poashtu nivel shumë i ultë i përkrahjes për organizim të aktiviteteve të ndryshme promovuese shëndetësore qoftë nga shkolla, nga organizata të tjera apo nga institucionet lokale.

Vetëm rreth 30% e mësimeve të mesme respondentë kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit, kanë punuar ata ose të tjerët në mbikëqyrjen ose koordinimin e promovimit shëndetësor në këtë shkollë në aktivitete me stafin arsimor shëndetësor.

Rezultat më i mirë është deklaruar vetëm në lidhje me shqyrtimin e kujdesit oral dhe vaksinimit, me ç'rast rreth 90% e mësimeve të mesme kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit shkolla ka organizuar aktivitete promovuese për shqyrtimin oral ose vaksinim për nxënës, përderisa rreth 80% e nxënësve kanë deklaruar se në shkollë gjatë 12 muajve të fundit, është ofruar ndonjë formë e shqyrtimit oral shëndetësor ose vaksinimi për nxënës.

Ndërsa sa i përket mbështetjes për aktivitetet promovuese, rreth 40% e mësimeve të mesme kanë deklaruar se nuk janë ofruar aktivitete ose shërbime për shkollën nga organizatat joqeveritare (OJQ), apo institucione shëndetësore lokale, ndërsa në mesin e nxënësve rreth 45% të respondentëve kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit nuk është ofruar ndonjë aktivitet ose shërbime për shkollën nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal.

Në pothuajse të gjitha pyetjet tjera në lidhje me aktivitete promovuese ka pasur përgjigje të cilat tregojnë përqindje të ultë të aktiviteteve. Kështu, për shembull, rreth 75% e nxënësve kanë deklaruar se nuk kanë pasë mbështetje për aktivitete promovuese si programet për humbje në peshë apo programe për ndërprerjen e duhanit.

Ndërsa, një dallim evident në deklarin e nxënësve dhe të mësimdhënësve është edhe në lidhje me ndërmarrjen e aktiviteteve ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet e shfaqura në mediat elektronike të shkollës. Rreth 60% e mësimdhënësve kanë deklaruar se janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet e shfaqura në mediat elektronike të shkollës, ndërsa 50% e nxënësve kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet në mediat elektronike të shkollës.

Rreth 45% të respondentëve kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit nuk është ofruar ndonjë aktivitet ose shërbime për shkollën nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal, ndërsa 55% kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për shkollën nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal.

Nga gjithë këto të dhëna mund të themi se në shkollën fillore “Zef Lush Marku” në Brekoc-Gjakovë, ka mungesë të aktiviteteve promovuese, dhe të mbështetjes së nevojshme për aktivitete të këtij lloji.

Prandaj, në të ardhmen duhet të ketë rritje të aktiviteteve dhe të mbështetjes në këtë drejtim. Aktivitetet promovuese në shkolla janë të domosdoshme për nxënësit në rritjen e vetëdijes dhe kujdesit për jetë më të shëndetshme.

7. PËRFUNDIMI

Të dhënat e raportuara në këtë studim tregojnë për nivel jo të kënaqshëm të aktiviteteve promovuese në shkollë. Hulumtimi me mësimdhënës dhe me nxënës tregon se për një nivel mjaft të ultë të aktiviteteve promovuese dhe poashtu nivel shumë të ultë të përkrahjes për organizim të aktivitetve të ndryshme promovuese shëndetësore qoftë nga shkolla, nga organizata të tjera apo nga institucionet lokale.

Prandaj, në të ardhmen duhet të ketë rritje të aktiviteteve dhe të mbështetjes në këtë drejtim. Aktivitetet promovuese në shkolla janë të domoshdoshme për nxënësit në rritjen e vetëdijes dhe kujdesit për jetë më të shëndetshme. Prandaj shkolla duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për zhvillim të programeve që do të tërheqin dhe sigurojnë mbështetjen për aktivitete të ndryshme promovuese dhe të edukimit shëndetësor.

8. REKOMANDIME

Mbështetur në gjetjet dhe rezultatet e këtij hulumtimi, mund të rekomandohen masat në vijim:

1. Kërkohe organizimi dhe mbështetja e më shumë aktiviteteve rreth promovimit shëndetësor me qëllim të rritjes së vetëdijes dhe kujdesit për jetë më të shëndetshme;
2. Të ofrohen më shumë shërbime dhe aktivitetet në lidhje me kujdesin oral shëndetësor, si dhe mirëmbajtje e kalendarit të vaksinimit të nxënësve;
4. Më shumë aktivitete promovuese të tilla si programet e humbjes në peshë, ose programe për ndërprerjen e duhanit;
5. Më shumë publikime për promovimin e shëndetit për ngritje të vetëdijes së nxënësve apo komunitetit në tërësi, në formë të broshurave, posterëve dhe formave të tjera të promovimit;
6. Organizimi i më shumë aktiviteteve ose programeve të ndryshme midis grupeve të shkollës, si gara në mes nxënësve nga klasat e ndryshme me qëllim të nxitjes së nxënësve në edukim shëndetësor;
7. Gjetja e mundësive për të fituar mbështetjen për aktivitetet promovuese në shkollë nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal;
8. Të hartohet një Program i aktiviteteve promovuese shëndetësore në shkollë duke u mbështetur në Strategjinë e promovimit të shëndetit në shkolla.

9. REFERENCAT

1. Victoria Health Department. "Health promotion"
<https://www.vichealth.vic.gov.au/about/health-promotion>
2. "Health promotion" <https://www.flyingdoctor.org.au/qld/our-services/primary-health-care-services/health-promotion-qld/>
3. "Health promotion an effective tool for global health" <http://www.pubpdf.com/pub/22529532/Health-promotion-an-effective-tool-for-global-health>
4. "Health Promotion". Australian Health Promotion Association, Australia, 2009
<https://www.healthpromotion.org.au/our-profession/what-is-health-promotion>
5. "The Ottawa Charter for Health Promotion"
<http://www.who.int/healthpromotion/conferences/previous/ottawa/en/index4.html>
6. Terris M. Concepts of health promotion: dualities in public health theory. J Public Health Policy. 1992;13:267–76. [PubMed] : <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3326808/>
7. Gentiana Qirijako, Genc Burazeri, Enver Roshi, Drita Gera: Shëndeti publik. Tiranë
8. Sarah Stewart-Brown. Health promotion. Health Division of Health in the University of Warwick Coventry United Kingdom
9. MASHT. Raporti "Shkollat promovuese të shëndetit nëpër vite", Prishtinë 2013
<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/11/merged-document-2.pdf>
10. Xheladin Sh. Ujkani. Raporti përfundimtar i javës së promovimit të shëndetit, "Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur" (23-30 Prill, 2013)
11. MASHT. "Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë" Prishtinë 2009
<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/stretegjia-per-shpsh-ne-kosove.pdf>
12. CDC. "Health Promotion Strategy" . CDC Atlanta,
<https://www.cdc.gov/healthyschools/parentengagement/parentsforhealthyschools.htm>
13. CDC. Faculty and staff health promotion school questionnaire. CDC, Atlanta, 2008.
<https://ftp.cdc.gov/pub/data/YRBS/SHPPS/SHPPS%202006%20Files/Questionnaires/faculty12006questionnaire.pdf>

ANEKS

PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËS NË LIDHJE ME PROMOVIMIN SHËNDETËSOR NË SHKOLLA

Gjinia : F M

Mosha : 25-35 36-49 50+

1. Gjatë 12 muajve të fundit, a ka ofruar shkolla juaj shqyrtimin oral shëndetsorë ose vaksinimin për nxënës?
 - Po
 - Jo
2. Gjatë 12 muajve të fundit, a ka ofruar shkolla juaj arsimim rreth menaxhmit të ushqimit, aktivitete fizike apo këshillim në palestër?
 - Po
 - Jo
3. Gjatë 12 muajve të fundit, shkolla juaj a ka ofruar shërbimet e identifikimit për abuzim fizikë, seksual, ose emocional për nxënës ?
 - Po
 - Jo
4. Gjatë 12 muajve të fundit a keni marrë ndonjë subvencion për aktivitete promovuese, të tilla si programet humbje në peshë, ose programe për ndërprerjen e duhanit ?
 - Po
 - Jo
5. Gjatë 12 muajve të fundit, a ju ka vlerësuar shkolla për aktivitete shëndeti ose shërbime të promovimit?
 - Po
 - Jo

6. Gjatë 12 muajve të fundit, a ka siguruar shkolla juaj dhurata, njohje publike, certifikata apo çmime për pjesëmarrje në programet e promovimit të shëndetit?

- Po
- Jo

7. Gjatë 12 muajve të fundit, a është ofruar ndonjë aktivitet ose shërbime për shkollën nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal ?

- Po
- Jo

8. Gjatë 12 muajve të fundit a janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet shfaqën në mediat elektronike të shkollës ?

- Po
- Jo

9. Gjatë 12 muajve të fundit a ka ndonjë aktivitet ose programe fizike të ndryshme midis grupeve të shkollës, p.sh. një garë në mes nxënësve nga klasat e ndryshme?

- Po
- Jo

10. Gjatë 12 muajve të fundit, a keni punuar ju ose të tjerët në mbikëqyrjen ose koordinimin e promovimit shëndetësor në këtë shkollë në aktivitete me stafin arsimor shëndetësor?

- Po
- Jo

Koment shtesë _____

**PYETËSOR PËR NXËNËSIT NË LIDHJE ME PROMOVIMIN SHËNDETËSOR NË
SHKOLLA**

Gjinia : F M

1. Gjatë 12 muajve të fundit, a ka ofruar shkolla juaj shqyrtimin oral shëndetsorë apo vaksinimin për nxënës?
 - Po
 - Jo
2. Gjatë 12 muajve të fundit, a ka ofruar shkolla juaj arsimim rreth menaxhimit të ushqimit, aktivitete fizike apo këshillim në palestër?
 - Po
 - Jo
3. Gjatë 12 muajve të fundit, shkolla juaj a ka ofruar shërbimet e identifikimit për abuzim fizikë, seksual, ose emocional për nxënës ?
 - Po
 - Jo
4. Gjatë 12 muajve të fundit a keni marrë ndonjë subvencion për aktivitete promovuese, të tilla si programet humbje në peshë, ose programe për ndërprerjen e duhanit ?
 - Po
 - Jo
5. Gjatë 12 muajve të fundit, a ju ka vlerësuar shkolla për aktivitete shëndeti ose shërbime të promovimit?
 - Po
 - Jo

6. Gjatë 12 muajve të fundit, a ka siguruar shkolla juaj dhurata, njohje publike, certifikata apo çmime për pjesëmarrje në programet e promovimit të shëndetit?

- Po
- Jo

7. Gjatë 12 muajve të fundit, a është ofruar ndonjë aktivitet ose shërbime për shkollën nga ndonjë organizatë joqeveritare (OJQ) apo institucion shëndetësor lokal ?

- Po
- Jo

8. Gjatë 12 muajve të fundit a janë ndërmarrë aktivitete ose shërbime për të publikuar promovimin e shëndetit si posterët në shkollë apo njoftimet shfaqën në mediat elektronike të shkollës ?

- Po
- Jo

9. Gjatë 12 muajve të fundit a ka ndonjë aktivitet ose programe fizike të ndryshme midis grupeve të shkollës, p.sh. një garë në mes nxënësve nga klasat e ndryshme?

- Po
- Jo

10. Gjatë 12 muajve të fundit, keni punuar ju ose të tjerët në mbikëqyrjen ose koordinimin e promovimit shëndetsor në këtë shkollë në ato aktivitete me stafin arsimor shëndetësor?

- Po
- Jo

Koment shtesë _____ 13

BIOGRAFI E SHKURTËR E KANDIDATIT – CV (Curriculum Vitae)

Informatat personale:	
Emri dhe Mbiemri	Ilir Kqira
Datëlindja	03.02.1994
Gjinia	Mashkull
Nr. Personal	1234035424
Të dhënat kontaktuese:	
Nr. Tel:	+37744808286
Adresa	Zhub, Gjakovë
Emaili	Ilir.kq@gmail.com
Të dhënat e kualifikimit	
Shkolla e mesme e lartë	Mjekësi e përgjithshme “Hysni Zajmi” Gjakovë
Universiteti	Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”
Fakulteti	Fakulteti i Mjekësisë
Programi	Infermieri
Statusi	I rregullt
Nr. ID	130306055